

Data 03.03.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: Blerje kamion me kapacitet te mesem

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 42415200-0

VLERA E FONDIT LIMIT: 23.200.000 (njezet e tre milion e dyqind mije) Lekë pa TVSH, ekuivalente ne 241.189 Euro (dyqind e dyzete e nje mije e njeqind e tetedhjetë e nente) me kurs kembimi 96.19 dt.03.03.2026

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Eco Tirana sh.a. ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Kerkesat e mesiperme jane detyruese dhe i sherbejne Autoritetit Kontraktor per te krijuar bindjen e tij se operatorët ekonomik pjesëmarrës ushtrojnë veprimtarinë e tyre konform kërkesave të legjislationit në fuqi, përmbushin kriteret ligjore për të marrë pjesë në procedura prokurimi si dhe kanë shlyer të gjitha detyrimet sipas përcaktimeve të legjislationit përkatës.

Po ashtu, paraqitja e sigurimit te ofertes eshte detyrim ligjor i percaktuar nga legjislacioni ne fuqi, si nje mjet garancie per Autoritetin Kontraktor ne rast te tërheqjes së ofertës pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave; refuzimit për nënshkrimin e kontratës së prokurimit apo mosparaqitjes së sigurimit të kontratës, kur oferta është shpallur fituese, ose mosplotësimit të ndonjë kushti tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentet e tenderit.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.1.1. Operatori ekonomik duhet të dorëzojë elektronikisht Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, duke e plotësuar bashkëlidhur me nje deklaratë Referuar Ligji 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik” , Operatori ekonomik duhet te kete të regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi; operatori ekonomik duhet te kete përmbushur detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni për pagat; operatori ekonomik nuk duhet te kete asnje anëtar te një organi administrimi, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, i operatorit ekonomik, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij; te dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë për shkelje të rëndë profesionale.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të LPP,pika 1 a dhe 2 si dhe nenit 22 te ligjit nr. 16 dt.08.02.2024 ”Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

(Shënim: përcaktoni **nëse është rasti**, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit).

2.1.2. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me licencë VII3B2 për Shitblerjen e mjeteve rrugore me motor dhe/ose e rimorkiove,te reja ose te perdora me Autorizim Prodhuesi, ose ekuivalente.

Argumentimi Në bazë të pikës 1, germa a, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5,germa a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, gjithashtu mbështetur edhe mbi ligjin nr.10081 datë 23.02.2009 “Për Licencat autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqiperise” i ndryshuar VKM-në Nr 538 date 26.05.2009; si dhe Udhezimit Nr.1546 dt.29.03.2016.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për prodhimin dhe/ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

(Shënim: përcaktoni **nëse është rasti**, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022-2023-2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera limit e kontratës që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e LPP, si dhe nenin 43, pika 1 dhe pika 2 germa b) dhe pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e vlerës është përcaktuar bazuar në nenin 43, pika 2 germa b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike".

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore të çertifikuara të paraqitura pranë autoriteteve tatimore përkatëse, për vitet financiare 2022 – 2023 dhe 2024, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të Ligjit për Kontabilitetin dhe raportimin financiar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

(Shënim: ky kriter vendoset vetëm në rastet kur vlerësohet nga autoriteti/enti kontraktor)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

- 2.3.1.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 39 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 39 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Referuar VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” nenit 40, pika 4 ku është përcaktuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, për të vërtetuar aftësitë teknike të OE me qëllim përmbushjen nevojave të AK.

2.4.Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

- 2.4.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar për produktet e ofruara ku të përcaktohen edhe kontaktet e prodhuesit ose distributorit të autorizuar. Në rast se një autorizim paraqitet nga distributori i autorizuar, lidhja, bashkëpunimi i kontratës / furnizimit, ndërmjet distributorit të autorizuar dhe prodhuesit duhet të jetë e paraqitur me dokumentacionin përkatës.
- 2.4.2. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatën ISO 9001: 2015 në lidhje me sistemin e menaxhimit të cilësisë ose ekuivalent. Certifikata duhet të jetë e vlefshme dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga RSH”.
- 2.4.3. Operatori ekonomik duhet të deklarojë se do të dorëzojë mjetet prane ambjenteve të Selisë Operative të Eco Tirana Sh.a. ish parku i autobusave Rruga Don Bosko Tiranë sipas grafikut të lëvrimin të mallit dhe se ofron 24 muaj garanci për mjetet e reja objekt prokurimi.

Argumentim: Në bazë të nenit 77 pika 4 të Ligjit Nr 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikës 6, gërma c dhe pikës 8 të nenit të 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe pikës 1 të nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Hartimi i specifikimeve teknike është kryer nga Eco Tirana sh.a. duke iu referuar kërkesave dhe nevojave të autoritetit kontraktor Eco Tirana sh.a. në fushën e veprimtarisë së tij, referuar blerjeve të mëparshme dhe kryerjes së shërbimit ku ushtron aktivitetin në bazë të kontratës së shërbimit të administrimit të mbetjeve urbane dhe zgjerimit të shërbimit.

ARTIKULLI/ ARTICOLO	PERSHKRIMET/SPERCIFIKIMET TEKNIKE DESCRIZIONE /SPECIFICHE TECNICHE	NJESI MATESE/ UNITA' DI MISURA	SASIA/ QUANTITA'
Kompatator i ri me ngarkim te pasem me 2 akse	Shasi me masë totale në tokë të barabartë me 18 tonë, me karakteristika minimale: • baza e rrotave jo më e madhe se 4200 mm • naftë; • P.T.T. 18000 kg; • emetimet e motorit në përputhje me standardin Euro 6; • 2 ace • vozitni majtas; • kambio manual ose semi automatik • pezullim pneumatik i pasëm me susta ajri; • kabinë e shkurtër me tre ndenjësë të miratuara dhe sedilje qendrore; • ngjyra e automjetit e bardhë sipas standardit RAL të prodhuesit; • fuqia jo më pak se 280 HP; • kondicioner i kontrolluar manualisht; • tymrat që dalin pas kabinës së shoferit në një pozicion vertikal ose anash shasisë; • Depozita ure 60 litra; • gomë rezervë ; • tahografi dixhital 4.0; • aksesore dhe pajisje për përdorim. KARAKTERISTIKAT E PËRGJITHSHME: Shasi me 2 akse, me një masë totale toke prej 18,000 kg, e pajisur me një kompaktor me ngarkesë të pasme të pajisur me një derë hapëse për shkarkim dhe një pllakë nxjerrëse mbeturinash, e cila gjatë ngarkimit vepron si një pjesë e kundërt presionit për të marrë ngjeshjen e materiale të ngarkuara. Kapaciteti i kutisë: min. 16 m3 Kapaciteti i pleshtit: min. 2 m3 Baza maksimale e rrotave të shasisë: 4200 mm Ngarkesa ligjore jo më pak se 6500 kg KARAKTERISTIKAT E KUTIVE: Kapaciteti i kutisë: minimumi 16 m3 Kutia duhet të jetë e bërë me një strukturë mbajtëse me një pikë rendimenti të lartë prej Fe510B tubulare drejtkëndëshe. Trupi duhet të instalohet në shasi duke përdorur një kornizë të veçantë (kundër kornizës) e bërë nga tuba drejtkëndëshe Fe510B.	Cope / Pezzi	2

	Nënkorniza dhe trupi duhet të ankorohen midis tyre dhe shasisë duke përdorur bulona specifike. Fundi i kutisë duhet të jetë prej fletë çeliku HARDOX400 rezistente ndaj konsumit (HB400 HARDNESS) me një trashësi minimale 4 mm. Fundi dhe çatia e kontejnerit duhet të jenë krejtësisht të sheshta pa lakime. Muret e trupit duhet të jenë me trashësi minimale 4 mm dhe prej Fe510B, duhet të jenë të lëmuara, të kalenderuara anash (trupi "i lakuar") dhe të pajisura me një unazë përforcuese të përparme dhe të pasme prej çeliku me tuba të lartë. qëndrueshmëri në tërheqje.enervation. Për të mbajtur ujërat e zeza, trupi duhet të jetë plotësisht i papërshkueshëm nga uji në të gjithë gjatësinë e tij dhe duhet të jetë i pajisur me një anë të përparme, e cila parandalon daljen e ujërave të zeza gjatë kthesës ose frenimit, me lartësi jo më pak se 50 cm. Kontejneri duhet të jetë i pajisur edhe me një valvul për kullimin e ujërave të zeza të paktën 2". DERA HAPJES E PASME: Dera e pasme duhet të jetë e tipit hapës dhe duhet të përmbajë brenda mekanizmin e ngjeshjes së tipit të artikuluar me një teh. Dera e pasme duhet të ankorohet në kontejnerin e mbeturinave me anë të kunjave me diametër 40 mm prej çeliku C45 që rrëshqasin në vrima në pjesën e sipërme dhe me anë të 4 grepave pasive në pjesën e poshtme. Hapja e derës duhet të bëhet nëpërmjet shtytjes së dy cilindrave hidraulikë, të vendosur në anët e derës, me veprim të dyfishtë dhe të pajisur me valvula bllokimi për të shmangur rëniet aksidentale në rast të dështimit të sistemit hidraulik. Për fazat e mirëmbajtjes, duhet të jetë i pranishëm të paktën një mbështetëse manuale e sigurisë. Dera duhet të hapet deri në një pjerrësi minimale prej 85° dhe pasi të arrihet hapja maksimale, të paktën tre cikle ngjeshjeje duhet të nisin automatikisht për të zbrazur plotësisht gropën. Për të garantuar një hidroizolim të përsosur, dera e pasme do të pajiset me një gome anti-acid deri në afërsisht 2 metra nga fundi i trupit. GROPA e NGARKIMI Gropa e ngarkimit do të vendoset në pjesën e poshtme të derës, e cila duhet të jetë e papërshkueshme nga uji dhe e ndërtuar me një fund HARDOX 500 që ka një fortësi minimale 500 HB dhe një trashësi minimale 6 mm dhe e pajisur me një grilë shkarkimi minimal 2" për të lejuar evakuimi e lengjeve prej tij. Muret anësore të gropes duhet të jenë prej 4 mm të trasha HARDOX450. Kapaku i ngarkimit duhet të jetë i pajisur me një anë të hapjes së pasme për të lehtësuar hedhjen e mbeturinave. Goja duhet të jetë e sensorizuar dhe të ketë një lartësi minimale nga toka prej 1450 mm		
--	--	--	--

	për të lejuar ciklin automatik të ngjeshjes dhe një lartësi prej afërsisht 1 metër me gojen e hapur. Gropa e ngarkimit duhet të jetë e ndërtuar në atë mënyrë që të lejojë ngarkimin përmes koshave dhe dërgimin me mjete satelitore; gjerësia e brendshme e gropes së ngarkimit duhet të jetë së paku 1950 mm. Kapaciteti i gropes: minimumi 2 m³ SISTEMI I NGJESHJES: LOPATA DHE KARROCA Ngjeshja e materialit të vendosur në grope duhet të bëhet me anë të sistemit të artikuluar me një teh dhe me anë të pllakës së nxjerrjes, e cila do të veprojë si një pjesë e ndarë kundër presionit dhe duhet të ketë një shkallë ngjeshjeje jo më pak se 6: 1. Tehu duhet të jetë prej tubi strukturor prej çeliku me ngarkesë Fe510B dhe mbulesë prej fletë çeliku 5 m të trashë. Karroca duhet të ndërtohet në Fe510B dhe HARDOX400 ose tub strukturor ekuivalent çeliku për të garantuar qëndrueshmërinë dhe efikasitetin e pjesëve në kontakt të drejtpërdrejtë me mbetjet. Karroca dhe lopata duhet të rrëshqasin mbi patina dhe të udhëhiqen nga një palë shufra lidhëse në pjesën e poshtme dhe nga udhëzues jo të drejtë në pjesën e sipërme. Lëvizja e lopatës dhe karrocës do të transmetohet nga 4 cilindra hidraulikë me frenim të dyfishtë, 2 të vendosur brenda gropes për lëvizjen e lopatës dhe 2 jashtë gropes për lëvizjen e karrocës. Sekuencat e punës së lopatës dhe karrocës duhet të kontrollohen nëpërmjet majave të presionit. Lëvizjet e lopatës dhe karrocës nuk duhet të ndërhyjnë me pajisjen ngritëse të koshit ose me mjetin satelitor gjatë shkarkimit. Funksionet e ngjeshjes dhe pajisjet e sigurisë duhet të menaxhohen nga një njësi e vetme e kontrollit elektronik e cila ka kontroll të vazhdueshëm të funksioneve të ndryshme të punës. CIKLET E NGJESHJES Sistemi operativ elektro-hidraulik i pajisjes duhet të kontrollohet nga një panel i posaçëm butonash i vendosur në anën e djathtë të derës së pasme, ndërsa komandat për kyçjen e ngritjes së energjisë duhet të vendosen në kabinë. Ciklet e ngjeshjes, të zgjedhura nga tastiera, duhet të jenë si më poshtë: 1) cikël manual me faza të vetme ose të vazhdueshme me komandë mbajtëse deri në ekzekutim 2) cikël automatik i vazhdueshëm (vetëm me derën e pasme të mbyllur) 3) një cikël i sinkronizuar për kosh Në modalitetin manual, sistemi duhet të kontrollohet nëpërmjet një levë të veçantë të lehtë për t'u përdorur.		
--	---	--	--

	Sistemi duhet gjithashtu të jetë i pajisur me butona emergjence dhe butona të verdhë të urgjencës për të liruar zonën e ngjeshjes në ndarjen e ngarkesës. SISTEMI SHKARKIMI Shkarkimi i kontejnerit duhet të bëhet nga ana e pasme pas ngritjes së derës dhe materiali duhet të zhvendoset nga një mur i lëvizshëm që rrëshqet mbi udhërrëfyes të drejtë të shtyrë nga një cilindër teleskopik me veprim të dyfishtë me zgjatime të mbështjellura dhe të kromuara, i kontrolluar nga një i para-kalibruar valvula për të garantuar kundër presionit në fazën e ngjeshjes. Pllaka e ejektorit duhet të lidhet me trupin nëpërmjet katër tapave rrëshqitëse vetëlubrifikuese të bëra nga materiali plastik special kundër acidit dhe kundër konsumit NYLATRON PA6GMN. Pjesa kryesore e ejektorit do të jetë prej metali për të përballuar të gjitha sforcimet e ngjeshjes dhe shkarkimit, e përbërë nga tub strukturor prej çeliku Fe510B me trashësi 4 mm me mbulesë fletë metalike 3 mm të trashë në Fe510B ose ekuivalente. NGRITJE KOSHAT Dera e pasme duhet të jetë e pajisur me një pajisje ngritëse të kontejnerëve me rrotullim të dyfishtë në përputhje me rregulloren 840 dhe duhet të lejojë zbrazen e koshave nga 120 litra në 1700 litra. Pajisja duhet të lejojë zbrazen e njëkohshme të dy koshave me ndihmën e bashkëngjitjes së krehrit dhe pa pasur nevojë të hapen krahët e aksesorëve 1100 dhe 1700. Mbërthimi i kosheve në raft duhet të ndodhë automatikisht gjatë ngritjes së kontejnerit/ve dhe i gjithë sistemi duhet të kontrollohet me PLC dhe nuk duhet të ketë ndërhyrje me sistemin e ngjeshjes. Dhëmbët e raftit nuk duhet të merren nga profili i krahut rrotullues të koshit, por duhet të punojnë në mënyrë të pavarur pa ndërhyrje. Kapaciteti ngritës i kasafortës së koshit duhet të jetë së paku 1000 kg. SISTEMI HIDRAULIK I gjithë sistemi hidraulik duhet të funksionojë nëpërmjet 2 pompave hidraulike të lidhura me ngritje të fuqisë së kutisë së marsheve të shasisë. Pajisja duhet të ketë një pajisje automatike të rregullimit të rpm të motorit, e cila lejon, me futjen e ngritjes së fuqisë, arritjen automatike të shpejtësisë së saktë të rrotullimit të motorit të mjetit motorik dhe, në të njëjtën kohë, anulimin e efektit. të çdo veprimi në pedalin e gazit të vendosur në kabinë. Të gjithë tubat dhe komponentët duhet të kenë madhësi për presione deri në 4 herë më të madhe se presioni i funksionimit. I gjithë sistemi hidraulik duhet të mundësohet nga një rezervuar i vetëm vaji i vendosur lart në pjesën e përparme të trupit. Rezervuari duhet të vendoset në një pozicion të ngritur dhe sasia e vajit duhet të	
--	---	--

	jetë së paku 160 litra për të lejuar shpërndarjen e duhur të nxehtësisë së akumuluar; nuk duhet të sigurohen shkëmbyes nxehtësie. Valvulat e kontrollit dhe balancimit duhet të kenë një logjikë funksionimi sa më të thjeshtuar për të lejuar kontrolle dhe restaurime të shpejta gjatë mirëmbajtjes dhe duhet të prodhohen nga prodhuesit kryesorë dhe të gjurmohen lehtësisht në tregtarët e zakonshëm të pjesëve të këmbimit. Cilindrat hidraulikë duhet të kenë madhësinë e duhur duke iu referuar seksioneve, trashësisë dhe cilësisë së lëndës së parë, si dhe nyjeve dhe seksionit të kunjave të fiksimit. I gjithë sistemi duhet të jetë i pajisur me filtra të posaçëm vaji për dorëzim dhe kthim. SISTEMI ELEKTRIK Sistemi elektrik duhet të ndërtohet sipas rregulloreve dhe duhet të ketë një vlerësim mbrojtjeje IP65. I gjithë sistemi i menaxhimit të pajisjeve duhet të jetë i llojit të teknologjisë elektromekanike të menaxhuar nga PLC ose analog (CanBus nuk lejohet). VENDODHJET E KOMANDIMIT Kontrollet e mëposhtme duhet të jenë të pranishme në zonën e pasme djathtas, në anën e derës së pasme: · komandat në lidhje me sistemin e ngjeshjes; · komandat në lidhje me sistemin e kasafortës së kontejnerëve; · ndalim emergjent; · ndriçimi i grykës së ngarkimit; · thirrje në kabinë; Kontrollet e mëposhtme duhet të jenë të pranishme në pjesën e pasme majtas, në anën e derës së pasme: · Ndalesa emergjente · Thirrja e kabinës Ne gabine duhet të jetë i pranishëm një monitor për të kontrolluar zonën e punës nga kabina dhe një panel të lehtë për t'u përdorur me kontrollet e butonave dhe dritat paralajmëruese të mëposhtme: - butoni i urgjencës - vendosja e ngritjes së fuqisë; - Kontrolli i dritës së ndezjes - çaktivizimi i sensorëve të mbështetëses së pasme me çelësin e duhur të sigurisë - drita paralajmëruese për praninë e njerezve në platformë - sportel i orarit të punës Në anën e majtë, pranë trupit, duhet të ketë një panel të veçantë butonash për fazat e shkarkimit dhe një panel të veçantë butonash për uljen e derës së pasme. AKSESORËT DHE PAJISJET MINIMAL TË KËRKOHEN: ☐ (3) dritat ndezëse me teknologji LED portokalli, sipas rregulloreve aktuale:		
--	---	--	--

	• nr. (1) në pjesën e përparme të trupit • nr. (2) në pjesën e pasme të derës ☐ (3) fenerët e rregullueshëm me teknologjinë LED me dritë të bardhë për ndriçimin e natës; ☐ parafanta të pasme ☐ aplikimi i paneleve retroreflektive dhe fluoreshente ☐ tabelat e kufirit të shpejtësisë ☐ njehsor oresh për regjistrimin e periudhës së punës, i shikueshëm në panelin e kontrollit në kabinën e shoferit; ☐ Për operacionet e mirëmbajtjes me derën e ngritur, duhet të sigurohen 2 shirita sigurie (në ngjyrë kontrast), integrale me derën, për ta kyçur atë. ☐ Strehimi i fshesës dhe lopatës lehtësisht i aksesueshëm i vendosur në anë të derës ☐ sinjal akustik gjatë kthimit të mjetit mbrapa ☐ sinjal akustik gjatë ngritjes së derës ☐ Pllakat e udhëzimeve dhe tabelat me mbulesë mëndafshi për të gjitha kontrollet e parashikuara në pajisje. Të gjitha kostot e transportit duhet të përfshihen në çmimin e furnizimit të automjeteve, dieta dhe akomodim për dy përfaqësues teknike të autoriteti kontraktues që do të dërgohen pranë ofruesit të suksesshëm të furnizimit që duhet të udhëzohet me rregullat e sigurisë për përdorimin e automjeteve, për mirëmbajtje të zakonshme / të jashtëzakonshme dhe për aktivitetet e riparimit të vetë automjeteve me qëllim që Autoriteti Kontraktues të bëhet i pavarur nga strukturat e jashtme për riparime dhe mirëmbajtje Në çmimin e furnizimit të automjeteve duhet të përfshihet në ngarkim të ofruesit furnizimi i filtrave për ndërrimet e vitit të parë të përdorimit për çdo automjet. Makinat të dorëzohen pranë zyres operative të Eco Tirana Sh.a ish parku i autobusave Don Bosko.		
--	--	--	--